



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

---

Numri i lëndës: 2024:285149

Datë: 28.02.2025

Numri i dokumentit: 06918423

**C.nr.1080/2024**

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtares Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Blerand Sopi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses G. P. me mbiemër të vajzërisë C. me .....të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Naim Rrecaj avokat në Obiliq, kundër të paditurit G. P., ....., me objekt kontesti për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim, jashtë seancës gjyqësore, më datë 27.02.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr kërkesëpadia me numër C.nr.1080/2024, e datës 04.09.2024, e paditëses G.P. me mbiemër të vajzërisë C. me ....., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Naim Rrecaj avokat në Obiliq, kundër të paditurit G. P., me ....., me objekt kontesti për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim.

II. Shuma prej 374.74 euro e deponuar në emër të përfaqësuesit të përkohshëm i kthehet paditëses përkatësisht, nga xhirollogaria – arka e kësaj gjykate, do t'i bartet në xhirollogarinë personale të avokatit Naim Rrecaj avokat në Obiliq.

A r s y e t i m

Paditësja G. P., përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, me datë 04.09.2024, në këtë gjykatë ka ushtruar padi, kundër të paditurit të lartcekur, me objekt për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim.

Përfaqësuesi i paditëses, përmes parashtresës së datës 07.02.2025, e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë e paraqitur në këtë gjykatë me datë 04.09.2024 ku si prove është dorëzuar edhe

deklarata e paditëses me shkrim të dërguar në formë elektronike, ku e njëjta e ka njoftuar gjykatën se me vetëdijen e plotë dhe pa presionin e askujt e tërheqë padinë ndaj bashkëshortit të saj G.P. me arsyetimin se do të vazhdojnë të jetojnë si bashkëshortë, ngase nuk kanë asnjë problem mes vete, ndërsa ka kërkuar nga gjykata që shpenzimet për punën e përfaqësuesit të përkohshëm në shumë prej 374.40 euro të deponuara në arkën e kësaj gjykate do ti kthehen përfaqësuesit të palës paditëse, meqenëse nuk janë krijuar shpenzime për përfaqësues të përkohshëm ngase në seancën e datës 10.02.2025 në gjykatë është paraqitur vet i padituri, ku po ashtu edhe i njëjti ka deklaruar se nuk kundërshton tërheqjen e kërkesëpadisë me arsyetimin se me bashkëshorten e tij edhe pse në largësi, qëndrojnë mirë.

Gjykata, në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2024:285149, 27.02.2025**

**Gjyqtari,**

**Valbonë Dërvodeli, d.v.**

**KËSHILLË JURDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.